



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/184
Datë: 15.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 06/56 të datës 26 janar 2022

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi Qeverisë Nr. 06/56 i datës 26 janar 2022 për emërimin e drejtorëve të Bordit të Ndërmarrjes Publike Qendrore, Posta e Kosovës Sh. A. si në vijim:
 - 1.1. Në vend të z. Fadil Bejta, kryesues emërohet znj. Hyrmete Mydyti.
2. Mandati i të emëruarës nga pika 1. e këtij Vendimi zgjatë sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 06/56 të datës 26 janar 2022, si pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 02/184
Datë: 15.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Programi për Reforma në Ekonomi 2024-2026.
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve që dokumentin nga pika 1. e këtij Vendimi ta dorëzojë tek Komisioni Evropian.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Programin nga pika 1. e këtij Vendimi t'ia procedojë për informim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 03/184
Datë: 15.01.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15 paragrafi 3. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, Vendimin e Qeverisë Nr. 29/112 të datës 13 dhjetor 2022, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 03/128 të datës 16 shkurt 2023, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 janar 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Riformulohet pika 2.1 e Vendimit të Qeverisë Nr. 08/182 të datës 10 janar 2024 me tekstin si në vijim:
 - Në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, ndahet shuma prej 11,000,000€ (njëmbëdhjetë milionë euro), në nën-programin "Departamenti i Skemave Sociale" me kod 01700, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", për zbatimin e masës 1. të Planit të Veprimit për zbutjen e ndikimit të menjëhershëm socio-ekonomik të krizës energjetike.
- Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 08/182 të datës 10 janar 2024.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI


Kyeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë